



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 213/3 prot.

Pukë, më 12.02 .2026

PROCESVERBAL I MBLEDHJES Së KËSHILLIT BASHKIAK PUKË
date 11. 02.2026

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 53, pika 3, shkronja "a" si dhe të nenit 56 të VKB nr. 14 datë 30.06.2020 "Rregullore e funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pukë" dhe në zbatim të vendimit të kryesisë së këshillit nr. 1 datë 03.02.2026, mbledhja e radhës e këshillit Bashkiak Pukë u zhvillua me datën **11.02.2026**, ora **13⁻³⁰** tek salla e Këshillit të Bashkisë Pukë, me këtë rend - dite: :

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 19.12.2025
2. Projekt-vendim : Për miratimin e dhënies së ndihmës ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **dhjetor 2025**.
3. Projekt-vendim : Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë , që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike.
4. Projekt-vendim : "Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 dhe buxhetin vjetor 2027"
5. Projekt-vendim : "Për përcaktim përdorimi fondi(Grant performance) me burim financimi i huaj"
6. Projekt-vendim : " Për miratimin e listës së ngastrave të fondit kullosor , që mund të jepen në përdorim për kullotje dhe kositje të përkohshëm"
7. Projekt-vendim : " Paketa fiskale 2026"
8. Dorëheqja e këshilltares Aida Cenaj, këshilltare e subjektit politik PSD.
9. Projekt-vendim: " Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" (pas vdekjes) i Bashkisë Pukë " Z. Rustem Furriku

10. Projekt-vendim: " Për dhënien e titullit "Qytetar Nderi" (pas vdekjes) i Bashkisë Pukë " Z. Pashk Kol Lleshi.
11. Të tjera.

Ne mbledhje moren pjese: Ferit Ringaj , zv/kryetari i Bashkise, Lavdie Terbuni, pergjegjese e zyres sociale , Sokol Gjoni , drejtor i burimeve njerezore, Fiqirete Latifi. Drejtore e Finances, Gjyste Marku pergjegjese e sektorit te taksave. Edmond Prendi Sektori i pyjeve.

Mbledhja filloi ne oren 13:30 . Jane prezent ne mbledhje 9 keshilltarë , pra eshte koorumi i domosdoshem per fillimin e mbledhjes.

Kryetari i keshillit z. Gjon Gjoka hapi mbledhjen dhe prezantoi projekt-rendin e dites te miratuar nga kryesia.

Pas diskutimit te anetareve, u hodh ne votim dhe u miratua rendi i dites , me 9 vota pro, 0 ,vota kunder, 0 vota abstenim.

1. Mbledhja vijoi me Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së dates 19.12.2025

U hodh ne votim dhe u miratua **procesverbali i mbledhjes së dates 19 .12.2025** me 9 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

2. Projekt-vendim për miratimin e dhënies së ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit dhjetor 2025.

Pyetje : Gj. Gjoka : A ka ndryshime?

D. Asani : Pse ndihma e dhjetorit ne shkurt?

Sqaron : Lavdie Terbuni: Jane personat qe nuk kane fituar nga pikezimi dhe kjo behet pasi mbyllet buxheti i muajit paraardhes.

B. Aliaj : Pse nuk eshte dhene pagesa per ndihme paaftesise?

L. Terbuni : Ka pase mungese fondi , por do tju jepen te dy muajt bashke.

U hodh ne votim dhe u miratua dhënia e ndihmes ekonomike duke përdorur deri në masën 6% të fondit total të ndihmës ekonomike të muajit **dhjetor** 2025, me 9 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.



3. Projekt-vendim : Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë , që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike.

Pyetje : Gj. Gjoka : Perse miratohen kriteret .

B. Aliaj : Pse nuk janë perfshirë grate e dhunuara?

Sqaron : Lavdie Terbuni: Sipas VKM perkatese miratohen ne keshille disa kriteret te vecanta per te trajtuar personat , qe nuk perfitojne ndihme nga pikezimi.

Zakonisht grate e dhunuara perfshihen tek skema e ndihmes dhe jo te 6%.

U hodh ne votim dhe u miratuan kriteret për familjet në nevojë , që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike per vitin 2026 , me 9 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

4. Projekt-vendim : “Për miratimin e kalendarit të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 dhe buxhetin vjetor 2027”

Sqaron : Fiqirete Latifi Ne zbatim te ligjit , meqenese miratimi i buxhetit kalon ne disa faza , eshte e domosdoshme te miratohet kalendari i miratimit te buxhetit afatmesem ne keshille.

U hodh ne votim dhe u miratua kalendari i përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm 2027-2029 dhe buxhetin vjetor 2027 me 9 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

5. Projekt-vendim : “Për përcaktim përdorimi fondi(Grant performance) me burim financimi i huaj”

Pyetje :

Sqaron : Fiqirete Latifi Ky eshte grant performance pjesa e financuar nga te huajt. Kemi nje financim nga keshilli i qarkut per te bere rikonstruksionin e Pallatit te kultures, por ky fond nuk mjafton per mobilimin dhe paisjen, prandaj kemi menduar ta bejme me kete buxhet.

F. Ringaj: Ky buxhet eshte perfiturar nga puna e mire gjithvjetore e administrates se Bashkise per hartimin e planeve dhe projekteve , te cilat jane shperblyer me kete grant performance.

U hodh ne votim dhe u miratua përdorimi i fondit (Grant performance) me burim financimi i huaj” me 9 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

6. Projekt-vendim : ” Për miratimin e listës së ngastrave të fondit kullosor , që mund të jepen në përdorim për kullotje dhe kositje të përkohshëm”

Pyetje : Gj. Gjoka : A ka interes?

E. Prendi : Ka disa te interesuar, por jo shume.

Sqaron: Edmond Prendi Kjo eshte lista e ngastrave te fondit kullosor , qe mund te jepen ne perdorim te perkohshem per kullota dhe kositje .

U hodh ne votim dhe u miratua lista e ngastrave të fondit kullosor , që mund të jepen në përdorim për kullotje dhe kositje të përkohshëm” , me 9 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

7. Projekt-vendim : ” Paketa fiskale 2026”

Pyetje: Gj. Gjoka: A ka ndryshim me vitet e meparshme?

D. Asani : Sa % e te ardhurave jane realizuar nga taksat ne vitit 2025?

Gj. Marku : Nuk ka ndryshim ne njesite vleresuese?

Gj. Marku : Jane realizuar 69% per vitin 2025. Kerkoj nga te gjithë qe te na mbeshtesni me mundesite dhe njohjet tuaja qe te rrisim realizimin e te ardhurave.

U hodh ne votim dhe u miratua ” Paketa fiskale 2026” , me 9 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

8. Dorëheqja e këshilltares Aida Cenaj, këshilltare e subjektit politik PSD.

Sqaron Komisioni i mandateve : eshte shprehur pro kalimit ne seance.

U hodh ne votim dhe u miratua Dorëheqja e këshilltares Aida Cenaj, këshilltare e subjektit politik PSD, me 9 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

Te njoftohet KQZ per vakancen ne keshill.

9. Projekt-vendim: ” Për dhënien e titullit ”Qytetar Nderi” (pas vdekjes) i Bashkisë Pukë ” Z. Rrustem Furriku

Sqaron : Sokol Gjoni: Ka qene mesues , qe ka lene gjurme ne fushen e arsimit ne edukimin e brezave. Ka kaluar te gjitha fazat e verifikimit dhe vleresimit dhe paraqitet para keshillit per vleresim me titullin ”Qytetar Nderi ” i Bashkise Puke, pas vdekjes.

U hodh ne votim dhe u miratua Projekt-vendim: ” Për dhënien e titullit ”Qytetar Nderi” (pas vdekjes) i Bashkisë Pukë ” Z. Rrustem Furriku , me 9 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

10. Projekt-vendim: ” Për dhënien e titullit ”Qytetar Nderi” (pas vdekjes) i Bashkisë Pukë ” Z. Pashk Pal Lleshi

Sqaron : Sokol Gjoni: Ka qene mesues , qe ka lene gjurme ne fushen e arsimit ne edukimin e brezave. Ka kaluar te gjitha fazat e verifikimit dhe vleresimit dhe paraqitet para keshillit per vleresim me titullin ”Qytetar Nderi ” i Bashkise Puke, pas vdekjes.

U hodh ne votim dhe u miratua Projekt-vendimi ” Për dhënien e titullit ”Qytetar Nderi” (pas vdekjes) i Bashkisë Pukë ” Z. Pashk Pal Lleshi me 9 vota pro, 0 vota kunder, 0 vota abstenim.

Ferit Ringaj: Falenderoj anetaret e keshillit , qe votuan per keto dy vleresime. Eshte ne nderin e bashkise dhe te keshillit , qe te vleresojne figura te tilla me rendesi per komunitetin e Pukes.

Te tjera: 1. Kerkese drejtuar keshillit nga Myftiu i Pukes z. Gezim Kopani, per emertim rruge, emertim monumenti natyror dhe per dhenie titull nderi . U lihet detyre zyrove perkatese ne Bashki , qe ne mbledhjet ne vijim te paraqiten me projekt-vendime per shqyrtim dhe miratim ne keshille.

F. Ringaj: Rasti i Adem Ademit eshte pas vdekjes dhe eshte shtetas i huaj.

2. Kerkese nga banoret e Lagjes Laçaj: Te verifikohet nga zyrat perkatese te bashkise .

3. Arben Guga : Kerkoj qe ne mbledhjen e radhes te raportojne ne keshill perfaqesues te OSHE , pasi ka shume probleme me faturat energjise elektrike ne Qelez.

4. Informim nga Bashkia Puke: Burimet njerezore informojne keshillin e Bashkise se Sekretari i keshillit ka plotesuar moshen 65 vjet, per te dale ne pension.


Hazbi Terbuni: Eshte e vertete qe kam plotesuar moshen 65 vjet. Se pari kjo eshte nje e drejte dhe jo detyrim. Se dyti pozicioni i sekretarit nuk eshte as nepunes civil dhe as nepunes i thjeshte, por eshte nje funksion i emeruar nominalisht nga keshilli dhe duke qene i till varet nga vendimarrja e keshillit. Por duhet te dini se as ne ligjin per veteqeverisjen vendore dhe as ne rregulloren e funksionimit te keshillit nuk eshte percaktuar kufi moshor per lirimin nga ky funksion. Gjithsesi une do te kerkoja nga ju deri ne fund te Prillit per te plotesuar vjetesine e punes per pension te plote.

Te gjithë keshilltaret ishin pro.

5. Mustaf Mehaj , kryetar i fshatit Puke dhe dashamires i sportit. Kam shume vite qe merrem me femijet e Pukes. Kena marre leje per te bere stervitje ne ambjentet e klubit sportiv. A eshte mundur qe te planifikohen nje sasi leksh per te mbeshtet stervitjen e femijve te Pukes? Megjithese kemi marre leje , shpesh kemi hasur pengesa per stervitje, per mirembajtjen e fushes, kositjen e barit etj.

F. Ringaj : Nuk do te keni me pengesa per stervitje.

%

A handwritten signature in blue ink is written over a circular official stamp. The stamp contains the text "REPUBLIKË E SHQIPËRISË" at the top and "BASHKIA E PUKËS" at the bottom, with a central emblem.

ALFONS - GJERGJAS

Goli Gjokaj

Basma Alij

Drita Beani

Aleksander Trusha

Harlan Feyi

Lere Kolaj

Alban Meksi

Besna Kuci

sekretari i keshit

Harizbi Tonburi

